



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 61 dt. 15.09.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.09.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar dhe më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Lidhur me projektin “Ristrukturimi i Sheshit Iliria”, nga Bashkia Durrës (faza e II),

• **KKR është kundër prishjes së shatërvanit si objekt.**

- KKR i propozon Bashkisë Durrës që brenda projektit të zhvillimit të kësaj faze, të rishikojë mundësinë e ruajtjes së shatërvanit në sheshin ku ndodhet.
- Në pamundësi të ruajtjes së tij (e argumentuar), Bashkia duhet të propozojë zhvendosjen e shatërvanit në një shesh tjetër me një kontekst arkitektonik të ri, të të njëjtës periudhë ndërtimi.

Për çdo vendimarrje mbi propozimet e mësipërme, Bashkia Durrës duhet të marrë miratimin në KKR dhe KKA.

2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI